

Shërbimi i Kujdestarisë



› Si mund t'ju ndihmojë?



Federal Public Service
Justice

.be

Kur mbërrini në Belgjikë

A jeni nën 18 vjeç dhe keni mbërritur në Belgjikë i pashoqëruar nga babai ose nëna? Jeni duke kërkuar ndihmë dhe vend për të fjetur, ose ju ka ndaluar policia... Nëse po, Shërbimi i Kujdestarisë, që është nën varësinë e Departamentit Federal të Drejtësisë, do të informohet për praninë tuaj në Belgjikë.

Shqetësimi parësor i Shërbimit të Kujdestarisë do të jetë që të sigurohet që ju të keni një vend ku të qëndroni.

Nëse nuk keni një vend ku të qëndroni, Shërbimi i Kujdestarisë do të sigurohet t'ju dërgojë te një qendër ku do t'ju ofrohet kujdes, një vend për të fjetur dhe ushqim.

Nëse po jetoni me anëtarë të familjes, me miq ose në një qendër për azilkërkues, sigurohuni që Shërbimit të Kujdestarisë t'i jepni adresën dhe numrin tuaj të telefonit. Kjo është tepër e rëndësishme për t'ju gjetur se ku jeni.



Kushtet që duhet të plotësoni

Për të përfituar ndihmë nga një kujdestar, ju duhet që:

- › të jeni nën moshën 18 vjeç;
- › të jeni në Belgjikë pa babanë ose nënën tuaj;
- › të vini prej një vendi jashtë Zonës Ekonomike Evropiane¹ ;
- › të keni bërë kërkesë për azil ose të jeni në Belgjikë pa leje qëndrimi.

Për të kuptuar planet tuaja, Shërbimi i Kujdestarisë mbledh sa më shumë informacion të jetë e mundur dhe mund të kërkojë t'ju takojë. Ju mund të na kontaktoni personalisht.

Nëse ju i plotësoni kushtet, Shërbimi i Kujdestarisë do të caktojë një kujdestar për ju sa më shpejt që të jetë e mundur.

1. Vendet e Zonës Ekonomike Evropiane janë: Gjermania, Austria, Belgjika, Danimarka, Spanja, Franca, Greqia, Finlanda, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Portugalia, Mbretëria e Bashkuar, Suedia, Qipro, Hungaria, Estonia, Polonia, Republika Çeke, Sllovenia, Letonia, Lituania, Sllovakia, Malta, Rumania, Bullgaria, Norvegjia, Islanda, Lihtenshteini.

Kush është Kujdestari?

Nëse qëndroni në Belgjikë, kujdestari është personi që do t'ju ndihmojë deri sa të mbushni 18 vjeç. Ai do të jetë në dispozicion t'ju ndihmojë dhe t'ju përfaqësojë juve. Ai do t'ju ndihmojë me procedurat administrative ose ligjore pranë Zyrës së të Huajve, në shkollë e në qendrat e strehimit. Ai do të jetë në dispozicion për të dëgjuar pyetjet e problemet tuaja, si dhe për të diskutuar me ju vendimet më të mira në realizimin e planit tuaj.

Kujdestari do t'ju vërë në kontakt me një avokat, për të cilin do të keni nevojë për të plotësuar të gjitha procedurat administrative dhe ligjore. Shërbimet e avokatit janë falas.

Me marrëveshjen dhe me ndihmën tuaj, kujdestari:

- do t'ju përfaqësojë në të gjitha çështjet ligjore dhe sidomos me procedurat që lidhen me qëndrimin tuaj në Belgjikë;
- do të krijojë një marrëdhënie besimi me ju dhe do t'ju vizitojë rregullisht;
- do të kërkojë që ju të keni kushte të përshtatshme jetese gjatë qëndrimit tuaj, do t'ju regjistrojë në shkollë dhe do të sigurojë që të merrni ndihmën e nevojshme mjekësore dhe psikologjike;

- › do të ulet me ju për të gjetur një zgjidhje afatgjatë që përputhet me projektet tuaja;
- › do t'ju ndihmojë të gjeni prindërit tuaj.

Ju do të merrni një letër me emrin dhe të dhënat e kontaktit të kujdestarit tuaj. Mbajeni me vete gjatë gjithë kohës, pasi do t'ju duhet sa herë që do të keni të bëni me autoritetet.

Edhe kujdestari do të marrë një letër me të dhënat tuaja të kontaktit. Kjo do t'i japë mundësinë Okujdestarit që t'ju kontaktojë sa më shpejt që të jetë e mundur. Kujdestarin tuaj mund ta kontaktoni në çdo kohë.



Mendimi juaj është i rëndësishëm

Nëse nuk jeni dakord me kujdestarin, bisedoni me të për këtë gjë!

Edhe Shërbimi i Kujdestarisë është në dispozicionin tuaj për të dëgjuar çështjet tuaja.

Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet, atëherë çështja do t'i kalohet gjykatës.

Kur të përfundojë kujdestaria, ne do t'ju dërgojmë një pyetësor. Kjo do të japë mundësinë neve të marrim mendimin tuaj mbi ndihmën që keni marrë.

Kur përfundon kujdestaria?

Kujdestaria përfundon në secilën nga rastet e mëposhtme:

- › babai ose nëna juaj është në Belgjikë,
- › ju mbushni moshën 18 vjeç,
- › ju largoheni nga Belgjika,
- › ju merrni kombësinë belge,
- › ju merrni leje qëndrimi të pakufizuar.

Këshilla praktike

Mos ngurroni të kontaktoni kujdestarin tuaj ose Shërbimin e Kujdestarisë: Detyra e tyre është që t'ju ndihmojnë juve.



Mbani mend që ta mbani me vete kartën e vogël të përfshirë këtu, që përmban të dhënat e kontaktit të shërbimit dhe ato të kujdestarit tuaj. Kjo është e rëndësishme, pasi ajo do t'ju duhet autoriteteve për të kontaktuar kujdestarin tuaj.

Respektoni orarin në të gjitha takimet që ju janë dhënë nga Shërbimi i Kujdestarisë, nga kujdestari juaj ose nga autoritetet.

Nëse ndryshoni vendin e banimit ose numrin tuaj të telefonit, të dhënat e reja të kontaktit jepjani kujdestarit tuaj.



Contact

Guardianship Service

115 boulevard de Waterloo

1000 Brussels

Telephone: 078 15 43 24

Fax: 02 542 70 83

Your guardian

Name and first name

Address

.....

Phone number / Mobile phone

E-mail

Fax

Communication and Documentation Service
Boulevard de Waterloo 115
1000 Brussels
Tél. : 02 542 65 11
www.just.fgov.be